



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 02.06.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.06.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Steller" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Gara e vrapimit "GJAKOVA TRAIL" ", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-26-2378-2-3-6, Nr. i brendshëm-632-26-005-236, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e vonuar- jashtë afatit kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Steller" SH.P.K., e dt.02.06.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Gara e vrapimit "GJAKOVA TRAIL" ", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-26-2378-2-3-6, Nr. i brendshëm-632-26-005-236, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 15.05.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 15.05.2026;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Steller" SH.P.K., me dt.02.06.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Gara e vrapimit "GJAKOVA TRAIL", Nr. i prokurimit- 632-26-2378-2-3-6, Nr. i brendshëm-632-26-005-236.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, nuk ka bërë pezullimin e lëndës, sepse ju si Operator ekonomik ankues keni bërë Kërkesë për rishqyrtim pas afatit ligjor(neni 60 paragrafi 60.1 nën b, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024.

Kërkesa për rishqyrtim, është dorëzuar me dt.02.06.2026, kurse dita e fundit për dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim ka qenë dt.20.05.2026, prandaj e njejta refuzohet si e vonuar, sepse nuk është dorëzuar brenda afatit

kohor të përcaktuar në nenin 60.1 (b), të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 :

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “ kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

b) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

Autoriteti kontraktues nuk mban përgjegjësi nëse ju nuk keni mundur të dorëzoni ofertën për arsye të problemit në sistem. Në këtë rast ju është dashur të veproni sipas nenit 32, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, pas kalimit të afatit ligjor për parashtrimin e kërkesave për rishqyrtim, me dt.22.05.2026 ka bërë Njoftimin për dhënie të kontratës dhe me dt.01.06.2026, nënshkrimin e kontratës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

